6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

8. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Lezhë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lezhë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Lezhë për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lezhë, pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Lezhë për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Lezhë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lezhë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË PRONË PRIVATE TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "NDËRTIMI I RRUGËS SHËNGJIN–BAKS-RRJOLL SEG 0+00 DERI 7+310"

	ZONA	TË DHËNAT E PRONARIT	TE DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)							TË DHËNAT E SHPRONËSIMIT			VLERA TOTALE E KOMPENSIMIT (LEK)	ADRESA		Shënime
		Emër Atësi Mbiemër	Zona kadastrale	Indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Volum	Faqe	Sipërfaqja totale e parcelës (m^2)	Zëri kadastral	Sipërfaqja shpronësim (m^2)	Çmimi (lek/m^2)	Vlera e tokës (lek)		Bashkia	Fshati	
1	Zona 3	Katerine Luc Ujka Fran Luc Pashko Mrike Luc Qotaj Pashko Luc Pashko Dile Luc Pellumbi	2569	K-34-76-(131-C)	358	Vol. 2	F. 108	14010	Pyll	607.24	2,848.69	1,729,839.73	1,729,839.73	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Zona 3	Katrine Luc Ujka Fran Luc Pasho Mrike Luc Gotaj Pashko Luc Pashko Dile Luc Pellumbi	2569	K-34-76-(131-C)	359	Vol 2	F. 109	1103	Arë	23.97	2,848.69	68,283.15	68,283.15	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja,
3	Zona 3	Zef Ndoke Ivanaj Lize Ndoke Nili Dielle Gjoke Ivanaj Gjeke Martin Ivanaj Drande Martin Ivanaj Pashke Martin Ivanaj File Marash Gruda Katrine Marash Gjoka Vat Marash Ivanaj Pashko Marash Ivanaj Llesh Marash Ivanaj Vitore Marash Pellumbaj Regjina Marash Ivanaj Pjeter Rrok Ivanaj Prendash Rrok Ivanaj Leke Rrok Ivanaj Mrij Rrok Dodaj Mark Nike Matusha Vitore Nike Gjondrekaj Prek Gjeto Ivanaj Drande Rrok Ivanaj Tom Gjeto Ivanaj Dede Luke Ivanaj Lene Luke Ejlli Tone Luke Macaj Palok Luk Ivanaj Pashke Luke Dokaj Prende Luke Dokaj Gjyste Luke Dokaj	2568	K-34-76-(114-D)	834	Vol. 4	F. 84	1582	Arë	564.78	2,848.69	1,608,884.27	1,608,884.27	Lezhë		Konfirmuar nga ASHK-ja
4	Zona 2	Katrine Luc Ujka Fran Luc Pashaj Mrike Luc Gotaj Pashko Luc Pashkaj Dile Luc Pellumbi	2569	K-34-76-(131-C)	1007	Vol. 5	F. 55	24754	Pyll	960.37	3,798.26	3,647,731.11	3,647,731.11	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja
5	Zona 3	Llesh Marash Ivanaj Pashko Marash Ivanaj Ded Luke Ivanaj Vat Marash Ivanaj Zef Ndok Ivanaj Vitore Marash Pllumbaj	2568	K-34-76-(114-D)	1059	Vol. 5	F. 59	71	Arë	38.18	2,848.69	108,763.06	108,763.06	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja

		Lize Ndokë Nili Gjek Martin Ivanaj Drande Martin Ivanaj Pashkë Martin Ivanaj File Marash Gruda Katrinë Marash Gjoka Reggina Marash Ivanaj Pjeter Rrok Ivanaj Prendash Rrok Ivanaj Lek Rrok Ivanaj Mark Nike Matusha Vitore Nike Gjondrekaj Prek Gjeto Ivanaj Drande Rrok Ivanaj Tom Gjeto Ivanaj Lenë Luk Ejlli Tone Luke Macaj Palok Luk Ivanaj Pashke Luke Dokaj Prendë Luk Dokaj Gjyste Luk Dokaj Diella Gjok Ivanaj Mrij Rrok Dodaj														
6	Zona 3	Nikoll Prek Celaj	2568	K-34-76-(131-A) - 130-B	1000/24	Vol. 5	F. 191	2810	Pyll	41.92	2,848.69	119,417.17	119,417.17	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
7	Zona 3	Klemend Shemsi Vata	2568	K-34-76-(131-A)	1000/28-1	Vol. 5	F. 208	7618	Pyll	130.52	2,848.69	371,811.28	371,811.28	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
8	Zona 3	Tanushaj 2012	2568	K-34-76-(130-B- 131-A)	1000/67	Vol. 7	F. 99	14450	Pyll	2191.00	2,848.69	6,241,484.17	6,241,484.17	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
9	Zona 3	Lenë Kol Ivanaj	2568	K-34-76-(130-B- 131-A)	1000/74	Vol . 7	F. 106	1659	Pyll	53.20	2,848.69	151,550.41	151,550.41	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
10	Zona 2	Tom Gjeto Margjonaj	2569	K-34-76-(131-C)	1004/14	Vol. 8	F. 31	1000	Pyll	327.55	3,798.26	1,244,118.75	1,244,118.75	Lezhë		Konfirmuar nga ASHK-ja
11	Zona 2	Tom Gjeto Margjonaj	2569	K-34-76-(131-C)	1004/15	Vol. 8	F. 32	1000	Pyll	291.47	3,798.26	1,107,077.68	1,107,077.68	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja
12	Zona 3	Kanto Marash Gjoka	2568	K-34-76-(131-A) - 131-C	1016/11	Vol. 6	F. 222	6000	Pyll	353.96	2,848.69	1,008,323.02	1,008,323.02	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
13	Zona 3	Pashke Prek Gropçaj	2568	K-34-76-(131-A) - 131-C	1016/13	Vol. 6	F. 223	6406	Pyll	371.09	2,848.69	1,057,121.11	1,057,121.11	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
14	Zona 3	Gjon Mark Marku	2568	K-34-76-(131-A) - 131-C	1016/14	Vol. 6	F. 224	6202	Pyll	317.05	2,848.69	903,177.80	903,177.80	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
15	Zona 3	Kantarena Gjelaj	2568	K-34-76-(131-A) - 131-C	1016/16	Vol. 6	F. 229	3000	Pyll	284.28	2,848.69	809,826.16	809,826.16	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
16	Zona 3	Pjeter Zef Celaj Nik Zef Celaj Nush Zef Celaj	2568	K-34-76-(131-A) - 131-C	1016/5	Vol. 6	F. 52	300	Pyll	158.74	2,848.69	452,201.37	452,201.37	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
17	Zona 3	Haxhi Sadri Bardhi	2568	K-34-76-(131-A) - 131-C	1016/8	Vol. 6	F. 90	12675	Pyll	13.80	2,848.69	39,311.95	39,311.95	Lezhë		Konfirmuar nga ASHK-ja
18	Zona 3	Marash Mark Ivanajnik Mark Ivanaj Age Mark Ivanaj Tereze Mark Ivanaj	2568	K-34-76-(114-C)	1072/3	Vol. 5	F. 206	10970	Pyll	2214.30	2,848.69	6,307,858.70	6,307,858.70	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
19	Zona 3	Marinte Fran Ivanaj	2568	K-34-76-(114-C)	1072/5	Vol. 6	F. 30	92400	Pyll	1617.80	2,848.69	4,608,613.92	4,608,613.92	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
20	Zona 3	Çesk Ded Ivanaj Ylli Gjon Ujka	2568	K-34-76-(114-C)	1075/17	Vol . 7	F. 48	26100	Pyll	669.60	2,848.69	1,907,484.16	1,907,484.16	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
21	Zona 3	Valentin Gjeto Ujka	2568	K-34-76-(114-C)	1075/20	Vol. 7	F. 58	14875	Pyll	502.20	2,848.69	1,430,613.12	1,430,613.12	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
22	Zona 3	Ylli Gjon Ujka Çesk Ded Ivanaj	2568	K-34-76-(114-C)	1075/20/1	Vol. 7	F. 52	3935	Pyll	215.04	2,848.69	612,582.73	612,582.73	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
23	Zona 3	Alfred Gjeto Ujka	2568	K-34-76-(114-C)	1075/21	Vol. 7	F. 57	14875	Pyll	461.60	2,848.69	1,314,956.23	1,314,956.23	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
24	Zona 3	Roza Luca	2568	K-34-76-(114-C)	1075/21/1	Vol. 7	F. 51	4050	Pyll	126.50	2,848.69	360,359.54	360,359.54	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga

		Agim Luca Denis Luca Pjeter Luca														ASHK-ja
25	Zona 3	Marie Pjeter Groshiti/Luca	2568	K-34-76-(114-C)	1075/22	Vol. 7	F. 50	4090	Pyll	488.40	2,848.69	1,391,301.17	1,391,301.17	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
26	Zona 3	Marije Pjeter Groshiti	2568	K-34-76-(114-C)	1075/22/1	Vol . 7	F. 50	4090	Pyll	148.99	2,848.69	424,426.62	424,426.62	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
27	Zona 3	Prel Pjeter Luca	2568	K-34-76-(114-C)	1075/23	Vol. 7	F. 49	4125	Pyll	129.85	2,848.69	369,902.66	369,902.66	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
28	Zona 3	Vitore Lekë Syli	2568	K-34-76-(114-C)	1075/24	Vol. 7	F. 71	11510	Pyll	369.40	2,848.69	1,052,306.82	1,052,306.82	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
29	Zona 3	Ylli Gjon Ujka	2568	K-34-76-(114-C)	1075/25	Vol. 7	F. 72	11510	Pyll	382.90	2,848.69	1,090,764.17	1,090,764.17	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
30	Zona 3	Ylli Gjon Ujka	2568	K-34-76-(114-C)	1075/27	Vol. 7	F. 74	15111	Pyll	472.50	2,848.69	1,346,006.97	1,346,006.97	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
31	Zona 3	Pëllumb Gjeto Ujka	2568	K-34-76-(114-C)	1075/30	Vol . 7	F. 131	7125	Pyll	507.90	2,848.69	1,446,850.67	1,446,850.67	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
32	Zona 3	Dod Lek Ujka	2568	K-34-76-(114-C)	1075/32	Vol. 7	F. 134	5756	Pyll	213.31	2,848.69	607,654.49	607,654.49	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
33	Zona 3	Ylli Gjon Ujka	2568	K-34-76-(114-C)	1075/33	Vol. 7	F. 135	5755	Pyll	214.19	2,848.69	610,161.34	610,161.34	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
34	Zona 3	Sokol Lek Ujka Valentin Gjeto Ujka Ylli Gjon Ujka Pëllumb Gjeto Ujka Alfred Gjeto Ujka Gezim Marash Ujka Dod Lek Ujka	2568	K-34-76-(114-C)	1075/34	Vol. 7	F. 138	28290	Pyll	224.88	2,848.69	640,613.86	640,613.86	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
35	Zona 3	Sokol Lek Ujka Valentin Gjeto Ujka Ylli Gjon Ujka Pëllumb Gjeto Ujka Alfred Gjeto Ujka Gezim Marash Ujka Dod Lek Ujka	2568	K-34-76-(114-C)	1075/35	Vol. 7	F. 139	2060	Pyll	86.79	2,848.69	247,237.98	247,237.98	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
36	Zona 3	Leze Gjeto Ujka Gezim Marash Ujka	2568	K-34-76-(114-C)	1075/39	Vol . 7	F. 177	110250	Pyll	837.40	2,848.69	2,385,494.68	2,385,494.68	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
37	Zona 3	Ylli Gjon Ujka	2568	K-34-76-(114-C)	1075/40	Vol. 7	F. 176	20875	Pyll	294.30	2,848.69	838,370.06	838,370.06	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
38	Zona 3	Ylli Gjon Ujka	2568	K-34-76-(114-C)	1075/5	Vol. 7	F. 3	43500	Pyll	1495.70	2,848.69	4,260,788.62	4,260,788.62	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
39	Zona 3	Kol Rrok Kunora	2568	K-34-76-(114-C)	1075/6	Vol. 7	F. 2	18000	Pyll	126.50	2,848.69	360,359.54	360,359.54	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
40	Zona 3	Mrike Ndue Vucaj/Ujka	2568	K-34-76-(114-C)	1075/8	Vol. 6	F. 250	12800	Pyll	840.10	2,848.69	2,393,186.15	2,393,186.15	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
41	Zona 5	Pjeter Gjergji Prela	2569	K-34-76-(131-A)	347/11	Vol. 10	F. 7	870	Pyll	312.22	2,373.91	741,182.18	741,182.18	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja
42	Zona 5	Dardan Hasan Zallimeri Sherif Zalli Eneida Hasan Zalli	2569	K-34-76-(131-C)	347/12	Vol. 10	F. 38	1505	Pyll	756.59	2,373.91	1,796,076.57	1,796,076.57	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja
43	Zona 5	Bashkim Mehmet Kamberi Enkeleida Hysen Kamberi	2569	K-34-76-(131-C)	347/13	Vol. 10	F. 39	500	Pyll	223.97	2,373.91	531,684.62	531,684.62	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja
44	Zona 5	Hasan Haxhi Zalli	2569	K-34-76-(131-A) - 131-C	347/3	Vol. 7	F. 209	1500	Pyll	225.00	2,373.91	534,129.75	534,129.75	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja
45	Zona 5	Pjeter Gjergji Prela	2569	K-34-76-(131-A) - 131-C	347/6	Vol. 7	F. 228	20275	Pyll	739.49	2,373.91	1,755,482.71	1,755,482.71	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja
46	Zona 5	Luk Prel Nikaj	2569	K-34-76-(131-A) - 131-C	347/7	Vol. 7	F. 229	3044	Pyll	179.49	2,373.91	426,093.11	426,093.11	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja
47	Zona 3	Pjeter Gjergji Prela	2569	K-34-76-(131-C)	351/11	Vol. 7	F. 224	41375	Pyll	986.20	2,848.69	2,809,380.05	2,809,380.05	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja
48	Zona 3	Nikë Prel Nikaj	2569	K-34-76-(131-A)	351/14	Vol. 11	F. 183	5341	Pyll	519.86	2,848.69	1,480,921.02	1,480,921.02	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja

49	Zona 3	Luk Prel Nikaj	2569	K-34-76-(131-A)	351/9	Vol. 7	F. 227	38008	Pyll	390.91	2,848.69	1,113,582.19	1,113,582.19	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja
50	Zona 3	Shoqeria "Serendipias Group" Shpk	2569	K-34-76-(131-C)	546/1	Vol. 6	F. 212	36900	Pyll	365.96	2,848.69	1,042,507.32	1,042,507.32	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja
51	Zona 3	Tom Nik Staka	2569	K-34-76-(131-C)	546/9	Vol. 7	F. 201	15425	Pyll	135.48	2,848.69	385,940.79	385,940.79	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja
52	Zona 2	Matrine Luc Ujka Mrike Luc Ujka Pashko Luc Çotaj Dile Luc Pellumbi Lene Pjetrushaj Tom Fran Pjetrushaj Ndoc Fran Pjetrushaj Angje Fran Martini Marc Fran Miraj	2569	K-34-76-(131-C)	563/5	Vol 7	F. 54	88297	Pyll	370.00	3,798.26	1,405,354.72	1,405,354.72	Lezhë		Konfirmuar nga ASHK-ja
53	Zona 2	Fran Ndoc Marku Marjana Sadik Marku	2569	K-34-76-(131-D)	567/34	Vol. 6	F. 194	2100	Pyll	729.92	3,798.26	2,772,423.02	2,772,423.02	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja
54	Zona 2	Violeta Luk Marku	2569	K-34-76-(131-D)	567/38	Vol. 6	F. 205	1250	Pyll	295.00	3,798.26	1,120,485.52	1,120,485.52	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja
55	s 2	Kozeta Jorgji Gjika Suvorov Shuaip Gjika	2569	K-34-76-(131-D)	567/66	Vol. 10	F. 44	2700	Pyll	704.40	3,798.26	2,675,491.53	2,675,491.53	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja
56	Zona 3	Gjon Njeri Nikoll Ivanaj Simon Ivanaj Pashk Ivanaj	2568	K-34-76-(114-C)	580/3	Vol. 6	F. 15	131200	Pyll	3751.50	2,848.69	10,686,868.04	10,686,868.04	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
57	Zona 3	Llesh Marash Ivanaj Pashko Marash Ivanaj Ded Luke Ivanaj Vat Marash Ivanaj Zef Ndok Ivanaj Vitore Marash Pllumbaj Lize Ndokë Nili Gjek Martin Ivanaj Drande Martin Ivanaj Pashkë Martin Ivanaj File Marash Gruda Katrinë Marash Gjoka Regjina Marash Ivanaj Pjeter Rrok Ivanaj Prendash Rrok Ivanaj Lek Rrok Ivanaj Mark Nike Matusha Vitore Nike Gjondrekaj Prek Gjeto Ivanaj Drande Rrok Ivanaj Tom Gjeto Ivanaj Lenë Luk Ejlli Tone Luke Macaj Palok Luk Ivanaj Pashke Luke Dokaj Prendë Luk Dokaj Gjyste Luk Dokaj Diella Gjok Ivanaj Mrij Rrok Dodaj	2568	K-34-76-(114-C-113-D)	580/8	Vol. 6	F. 238	58211	Pyll	1665.20	2,848.69	4,743,641.92	4,743,641.92	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
58	Zona 4	Viserjon Ndue Pjetrushaj	2569	K-34-76-(131-C)	730/10	Vol. 11	F. 24	19180	Pyll	655.00	2,373.91	1,554,911.05	1,554,911.05	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja
59	Zona 4	Viserjon Ndue Pjetrushaj Besjana Fatmir Saliaj	2569	K-34-76-(131-C-D-A-B)	730/100	Vol. 11	F. 25	216	Truall	107.17	2,373.91	254,411.93	254,411.93	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Legalizim Vendim nr. 1253, datë 28.2.2022, Godinë shërbimi 1, kati sipër shërbimi 72 m²
60	Zona 4	Paulo Pjetrushaj	2569	K-34-76-(131-C)	730/8	Vol. 10	F. 112	13397	Pyll	54.86	2,373.91	130,232.70	130,232.70	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja
61	Zona 4	Paulo Sokol Petrushaj	2569	K-34-76-(131-C-D-A-B)	730/9	Vol. 10	F. 113	6000	Pyll	838.20	2,373.91	1,989,811.36	1,989,811.36	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja
62	Zona 3	Verë Mirash Ivanaj	2568	K-34-76-(114-D)	811/0	Vol 4	F. 61	3026	Kullotë	10.31	2,848.69	29,370.01	29,370.01	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga

		Ledjano Artan Ivanaj Emiljan Artan Ivanaj Zef Mark Ivanaj Gjergj Mark Ivanaj Mrij Nikoll Metaj Luigj Nikoll Ivanaj Prenë Mirash Ivanaj Ndoc Nikoll Nikolla Vitore Prek Ivanaj Nikolin Prek Ivanaj Natalina Prek Luli Paulin Prek Ivanaj Vera Prek Gjekmarkaj Shkelzen Prek Ivanaj Ndue Pjetër Ivanaj														ASHK-ja
63	Zona 1	Nosh Tom Tamali	2569	K-34-76-(131-D)	812/10	Vol. 5	F. 166	1000	Pyll	135.28	4,747.82	642,285.09	642,285.09	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja
64	Zona 2	Syl Ushkin Brati	2569	K-34-76-(131-D)	812/24	Vol. 6	F. 33	2000	Pyll	127.73	3,798.26	485,151.24	485,151.24	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja
65	Zona 3	Nexhmije Shaban Katana Genti Remzi Katana Elton Remzi Katana Evis Remzi Katana	2569	K-34-76-(131-D)	812/3	Vol 4	F. 66	650	Pyll	18.60	2,848.69	52,985.67	52,985.67	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja
66	Zona 2	Genci Gani Daiu Almida Cezar Daiu	2569	K-34-76-(131-B)	812/45	Vol. 6	F. 170	2000	Pyll	316.59	3,798.26	1,202,489.87	1,202,489.87	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja
67	Zona 2	Vitore Vlash Keli	2569	K-34-76-(131-C)	812/47	Vol. 6	F. 243	2000	Pyll	509.00	3,798.26	1,933,312.30	1,933,312.30	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja
68	Zona 2	Tom Gjeto Margjonaj	2569	K-34-76-(131-C)	812/51	Vol. 6	F. 246	5832	Pyll	488.25	3,798.26	1,854,498.49	1,854,498.49	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja
69	Zona 1	Ali Zenon Berbati	2569	K-34-76-(131-D)	812/54	Vol. 7	F. 28	1000	Pyll	27.46	4,747.82	130,375.14	130,375.14	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja
70	Zona 2	Lullash Tom Tamali	2569	K-34-76-(131-D)	812/9	Vol. 5	F. 165	1000	Pyll	54.56	3,798.26	207,232.85	207,232.85	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja
71	Zona 1	Ndrek Gjon Deda	2569	K-34-76-(131-D)	817/7	Vol. 7	F. 6	1000	Pyll	4.60	4,747.82	21,839.97	21,839.97	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja
72	Zona 1	Besjan Rame Muja	2569	K-34-76-(131-D)	817/8	Vol. 7	F. 5	500	Pyll	11.70	4,747.82	55,549.49	55,549.49	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja
73	Zona 3	Verë Mirash Ivanaj Ledjano Artan Ivanaj Emiljan Artan Ivanaj Zef Mark Ivanaj Gjergj Mark Ivanaj Mrij Nikoll Metaj Luigj Nikoll Ivanaj Prenë Mirash Ivanaj Ndoc Nikoll Nikolla Vitore Prek Ivanaj Nikolin Prek Ivanaj Natalina Prek Luli Paulin Prek Ivanaj Vera Prek Gjekmarkaj Shkelzen Prek Ivanaj Ndue Pjetër Ivanaj	2568	K-34-76-(114-C)	822/1	Vol. 5	F. 232	21889	Pyll	4393.60	2,848.69	12,516,013.17	12,516,013.17	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
74	Zona 3	Llesh Marash Ivanaj Pashko Marash Ivanaj Ded Luke Ivanaj Vat Marash Ivanaj Zef Ndok Ivanaj Vitore Marash Pllumbaj Lize Ndokë Nili Gjek Martin Ivanaj Drande Martin Ivanaj Pashkë Martin Ivanaj	2568	K-34-76-(114-C)	822/2	Vol. 5	F. 233	22807	Pyll	3783.20	2,848.69	10,777,171.57	10,777,171.57	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja

		File Marash Gruda Katrinë Marash Gjoka Regjina Marash Ivanaj Pjeter Rrok Ivanaj Prendash Rrok Ivanaj Lek Rrok Ivanaj Mark Nike Matusha Vitore Nike Gjondrekaj Prek Gjeto Ivanaj Drande Rrok Ivanaj Tom Gjeto Ivanaj Lenë Luk Ejlli Tone Luke Macaj Palok Luk Ivanaj Pashke Luk Dokaj Prendë Luk Dokaj Gjyste Luk Dokaj Diella Gjok Ivanaj Mrij Rrok Dodaj														
75	Zona 3	Llesh Marash Ivanaj Pashko Marash Ivanaj Ded Luke Ivanaj Vat Marash Ivanaj Zef Ndok Ivanaj Vitore Marash Pllumbaj Lize Ndokë Nili Gjek Martin Ivanaj Drande Martin Ivanaj Pashkë Martin Ivanaj File Marash Gruda Katrinë Marash Gjoka Regjina Marash Ivanaj Pjeter Rrok Ivanaj Prendash Rrok Ivanaj Lek Rrok Ivanaj Mark Nike Matusha Vitore Nike Gjondrekaj Prek Gjeto Ivanaj Drande Rrok Ivanaj Tom Gjeto Ivanaj Lenë Luk Ejlli Tone Luke Macaj Palok Luk Ivanaj Pashke Luke Dokaj Prendë Luk Dokaj Gjyste Luk Dokaj Diella Gjok Ivanaj Mrij Rrok Dodaj	2568	K-34-76-(114-D)	828/1	Vol. 6	F. 125	5396	Kullotë	1201.00	2,848.69	3,421,279.09	3,421,279.09	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
76	Zona 1	Shkelqim Isa Rexhepaj	2569	K-34-76-(131-D)	850/11	Vol 4	F. 64	820	Pyll	193.30	4,747.82	917,753.61	917,753.61	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
77	Zona 1	Gentjan Isa Rexhepaj	2569	K-34-76-(131-B)	850/6	Vol. 4	F. 79	1500	Pyll	4.70	4,747.82	22,314.75	22,314.75	Lezhë	Mali i Shëngjinit	Konfirmuar nga ASHK-ja
78	Zona 3	Llesh Marash Ivanaj Pashko Marash Ivanaj Ded Luke Ivanaj Vat Marash Ivanaj Zef Ndok Ivanaj Vitore Marash Pllumbaj Lize Ndokë Nili Gjek Martin Ivanaj Drande Martin Ivanaj Pashkë Martin Ivanaj File Marash Gruda	2568	K-34-76-(114-D)	880/1	Vol. 6	F. 124	10505	Kullotë	1685.00	2,848.69	4,800,046.02	4,800,046.02	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja

		Katrinë Marash Gjoka Regjina Marash Ivanaj Pjeter Rrok Ivanaj Prendash Rrok Ivanaj Lek Rrok Ivanaj Mark Nike Matusha Vitore Nike Gjondrekaj Prek Gjeto Ivanaj Drande Rrok Ivanaj Tom Gjeto Ivanaj Lenë Luk Ejlli Tone Luke Macaj Palok Luk Ivanaj Pashke Luk Dokaj Prendë Luk Dokaj Gjyste Luk Dokaj Diella Gjok Ivanaj Mrij Rrok Dodaj														
79	Zona 3	Gjelina Simon Vata Gjovalin Simon Ivanaj Luçe Simon Nikaj Nikoll Ivanaj Pashk Ivanaj Gjon Njeri	2568	K-34-76-(114-D-130-B)	938/41	Vol. 6	F. 174	62070	Pyll	136.36	2,848.69	388,447.64	388,447.64	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
80	Zona 6	Zef Kol Malotaj	2568	K-34-76-(130-B- 131-A)	981/10	Vol. 7	F. 119	2923	Pyll	142.92	2,373.91	339,279.22	339,279.22	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
81	Zona 6	Gjelosh Kol Malotaj	2568	K-34-76-(130-B- 131-A)	981/11	Vol. 7	F. 120	2923	Pyll	183.83	2,373.91	436,395.88	436,395.88	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
82	Zona 6	Arti Prek Tare	2568	K-34-76-(130-B-131-A)	981/12	Vol. 7	F. 121	3173	Pyll	191.35	2,373.91	454,247.68	454,247.68	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
83	Zona 6	Dod Kol Malotaj	2568	K-34-76-(130-B-131-A)	981/13	Vol. 7	F. 122	2923	Pyll	214.98	2,373.91	510,343.17	510,343.17	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
84	Zona 6	Llesh Kol Malotaj	2568	K-34-76-(130-B-131-A)	981/14	Vol. 7	F. 123	2924	Pyll	247.14	2,373.91	586,688.12	586,688.12	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
85	Zona 6	Mark Gjek Gjergji	2568	K-34-76-(130-B-131-A)	981/2	Vol. 7	F. 111	2275	Pyll	34.93	2,373.91	82,920.68	82,920.68	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
86	Zona 6	Mirash Fran Malotaj Luigj Fran Malotaj Lushan Fran Malotaj Simon Malotaj	2568	K-34-76-(130-B- 131-A)	981/4	Vol. 7	F. 113	2000	Pyll	271.43	2,373.91	644,350.39	644,350.39	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
87	Zona 6	Mirash Fran Malotaj	2568	K-34-76-(130-B- 131-A)	981/5	Vol. 7	F. 114	4510	Pyll	576.18	2,373.91	1,367,799.46	1,367,799.46	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
88	Zona 6	Luigj Fran Malotaj	2568	K-34-76-(130-B- 131-A)	981/6	Vol. 7	F. 115	4510	Pyll	427.60	2,373.91	1,015,083.92	1,015,083.92	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
89	Zona 6	Lushan Fran Malotaj	2568	K-34-76-(130-B- 131-A)	981/7	Vol. 7	F. 116	4510	Pyll	316.32	2,373.91	750,915.21	750,915.21	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
90	Zona 6	Simon Fran Malotaj	2568	K-34-76-(130-B- 131-A)	981/9	Vol. 7	F. 118	4510	Pyll	300.87	2,373.91	714,238.30	714,238.30	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
91	Zona 6	Pal Ndue Celaj Lize Fran Celaj	2568	K-34-76-(131-A)	991/14	Vol. 6	F. 28	10900	Pyll	136.99	2,373.91	325,201.93	325,201.93	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
92	Zona 6	Mirela Ndue Gjinkolaj	2568	K-34-76-(131-A)	991/18	Vol. 6	F. 26	1500	Pyll	515.63	2,373.91	1,224,059.21	1,224,059.21	Lezhë	Mali i Rencit	Konfirmuar nga ASHK-ja
										50037.10		**144,537,067.63**	**144,537,067.63**			

VENDIM
Nr. 289, datë 17.5.2023

PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, SI PJESË E FORCËS SHUMËKOMBËSHE DHE VËZHGUESVE (*MULTINATIONAL FORCE AND OBSERVERS, MFO*), NË SINAI, REPUBLIKA ARABE E EGJIPTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, "Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të shkronjës "ç", të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin e 3 (tre) ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë si pjesë e Forcës Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve (*Multinational Force and Observers, MFO*), në Sinai, Republika Arabe e Egjiptit.

2. Misioni i ushtarakëve është vëzhgimi i implementimit të masave të sigurisë të Traktatit të Paqes ndërmjet Egjiptit dhe Izraelit, të datës 26 mars 1979.

3. Kohëzgjatja e këtij misioni është 3 (tre) vjet, me rotacion deri në 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditë, afat i cili fillon të llogaritet nga data e nisjes së personelit për në mision.

4. Ministria e Mbrojtjes, për personelin pjesëmarrës në këtë mision, përballon shpenzimet për:

a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) siguracion shëndetësor jashtë zonës së misionit për ditët në udhëtim;

ç) transport të personelit;

d) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së misionit.

5. Transporti i personelit që shërben në Sinai, ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën për t'u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, lavanderia, transporti i individëve të shkëputur nga misioni për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, me përjashtim të rasteve kur arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dy-ose shumëpalëshe, ku pala tjetër merr përsipër përballimin e këtyre shpenzimeve.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet buxhetore të planifikuara në programin "Forca e luftimit".

7. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 290, datë 17.5.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 414, DATË 8.7.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE DHE KRITEREVE TË NDARJES DHE TË PËRDORIMIT TË FONDIT TË KUSHTËZUAR TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN CIVILE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 65, të ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 414, datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave, "shkronja "ë", e pikës 3.1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"ë) blerjen e automjeteve për përdorim të veçantë, makinave teknologjike dhe mjeteve rrugore të veçanta, të përcaktuara si të tilla, sipas parashikimeve të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, të cilat përdoren për përballimin e

situatave emergjente, të krijuara si pasojë e një fatkeqësie, si edhe për shpenzime të kryera për blerje karburanti dhe pjesësh ndërrimi për automjete dhe makineri, të cilat përdoren për përballimin e situatave emergjente, të krijuara si pasojë e një fatkeqësie.".

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, bashkitë dhe prefektët e qarqeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 292, datë 17.5.2023

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur, sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit ("Lista e OKB-së"), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Në listën e shkronjës "C", të titulluar "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (*Da'esh*) dhe *Al-Qaida*", shtohen dy individë, të renditur në shkronjën "a", sipas shtesës që i bashkëlidhet këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL (*Da'esh*) dhe *Al-Qaida*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

PËRDITËSIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT

("LISTA E OKB-së")

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT ISIL (*Da'esh*) dhe *Al-QAIDA*

a) Lista e shtuar në "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (*Da'esh*) dhe *Al-Qaida*":

1. MAULAWI; RAJAB
2. SULTAN AZIZ; AZAM

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personat, emrat e të cilëve janë renditur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

VENDIM
Nr. 293, datë 17.5.2023

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN 2023, NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË DHE MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në buxhetin e vitit 2023, në programin "Tregu i

punës", në artikullin 606, i pakësohet fondi prej 45 000 000 (dyzet e pesë milionë) lekësh.

2. Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në buxhetin e vitit 2023, në programin "Zhvillimi i turizmit", në artikullin 604, i shtohet fondi prej 45 000 000 (dyzet e pesë milionë) lekësh për zhvillimin dhe promovimin e destinacioneve, produkteve dhe diversifikimin e ofertës turistike në turizëm.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 294, datë 17.5.2023

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE RREGULLAVE, PËR PARAQITJEN E KËRKESAVE, PËR TË VEPRUAR SI ADMINISTRATOR NË PROCEDURAT E FALIMENTIMIT, SI DHE PROCEDURËN PËR DHËNIEN E HEQJEN E LICENCËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 42, të ligjit nr. 110/2016, "Për falimentimin", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i kritereve dhe rregullave të hollësishme për mënyrën e paraqitjes dhe trajtimin e kërkesave për të vepruar si administrator, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 110/2016, "Për falimentimin", si dhe procedurës për dhënien e heqjen e licencës.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllime të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Administrator", administratori i përkohshëm, administratori mbikëqyrës dhe administratori i falimentimit.
2. "Administrator i falimentimit", administratori i caktuar nga gjykata e falimentimit në vendimin për fillimin e procedurës së falimentimit ose pas hapjes së saj kur zëvendëson debitorin në administrimin dhe drejtimin e veprimtarisë.
3. "Agjencia Kombëtare e Falimentimit", autoriteti shtetëror kompetent për mbikëqyrjen, trajnimin dhe licencimin e veprimtarisë së administratorëve.
4. "Kandidat", individi që paraqet kërkesë pranë Agjencisë Kombëtare të Falimentimit për t'u licencuar si administrator.
5. "Licencë", akti administrativ që i njeh titullarit të saj të drejtën të fillojë e të ushtrojë profesionin e administratorit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.
6. "Provimi i kualifikimit", testimi i njohurive të kandidatëve që përmbushin kriteret për të qenë pjesë e tij, kalimi me sukses i të cilit mundëson ushtrimin e funksionit të administratorit.
7. "Regjistri i administratorëve", regjistri i administratorëve të certifikuar të falimentimit, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 110/2016, "Për falimentimin".

KREU II
KRITERET DHE PROCEDURA PËR DHËNIEN E LICENCËS

SEKSIONI 1
KRITERET E PËRZGJEDHJES DHE PARAQITJA E KËRKESAVE

Neni 3
Kriteret e përzgjedhjes

Kandidati duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë shtetas shqiptar;
b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të zotërojë një diplomë të ciklit të dytë të studimeve ose ekuivalente me të në shkenca ekonomike ose drejtësi;

ç) të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë pune në shkenca ekonomike ose drejtësi;

d) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

dh) të mos jetë shkarkuar nga ushtrimi i detyrës ose i funksionit publik për arsye të integritetit etik, me vendim të organit kompetent, që ka marrë formë të prerë, me përjashtim të rasteve kur kjo masë disiplinore është shuar sipas legjislacionit të posaçëm;

e) të ketë kryer me sukses provimin e kualifikimit;

ë) të ketë kryer pagesën e tarifës për pajisjen me licencë, sipas pikës 3, të nenit 23, të këtij vendimi.

Neni 4
Publikimi i thirrjes

1. Thirrja për shprehje interesi hapet të paktën 2 (dy) herë në vit dhe publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Falimentimit, të Ministrisë së Drejtësisë dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

2. Thirrja qëndron e hapur për një periudhë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e publikimit.

Neni 5
Paraqitja e kërkesës për shprehje interesi dhe dokumentacioni shoqërues

1. Kandidati paraqet kërkesën për shprehje interesi elektronikisht nëpërmjet shërbimit elektronik në portalin qeveritar *"e-Albania"* dhe ngarkon elektronikisht dokumentacionin shoqërues, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga përfundimi i afatit të publikimit të përcaktuar në nenin 4, të këtij vendimi.

2. Trajtimi i kërkesës për shprehje interesi dhe verifikimi i kritereve të kandidatëve kryhet nga struktura përgjegjëse për licencimin e administratorëve pranë Agjencisë Kombëtare të Falimentimit.

3. Kandidati depoziton kërkesën e tij të shoqëruar me këto dokumente:

a) jetëshkrim;

b) kërkesë për shprehje interesi;

c) vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore;

ç) kopje të njësuar të diplomës së ciklit të dytë të studimeve ose ekuivalente me të, lëshuar nga një institucion arsimor i akredituar në Republikën e Shqipërisë ose nga një institucion arsimor i huaj, të njohur e të njësuar nga ministria përgjegjëse për arsimin;

d) kopje të njësuar të librezës së punës ose çdo vërtetim tjetër, të lëshuar nga një autoritet shtetëror, që provon përvojën e punës në shkenca ekonomike ose drejtësi;

dh) vërtetim për pagesën e tarifës së provimit të kualifikimit për llogari të Agjencisë Kombëtare të Falimentimit.

4. Paraqitja e kërkesës dhe dokumenteve shoqëruese kryhet në rrugë elektronike, përmes portalit qeveritar "*e-Albania*".

5. Kandidati është përgjegjës personalisht për vërtetësinë dhe saktësinë e dokumentacionit, të depozituar pranë Agjencisë Kombëtare të Falimentimit.

Neni 6
Verifikimi paraprak

Struktura përgjegjëse për licencimin e administratorëve, pranë Agjencisë Kombëtare të Falimentimit, administron shprehjet e interesit dhe dokumentacionin shoqërues të kandidatit dhe, brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i afatit për paraqitjen e tyre, kryen veprimet e mëposhtme:

a) kur shprehja e interesit dhe dokumentacioni shoqërues është në përputhje me nenin 5, të këtij vendimi, njofton kandidatin, përmes portalit qeveritar *"e-Albania"* në rubrikën "Hapësira ime", për vazhdimin e procedurës së verifikimit të kritereve;

b) kur shprehja e interesit dhe dokumentacioni shoqërues nuk është në përputhje me nenin 5, të këtij vendimi, njofton kandidatin, përmes portalit qeveritar "*e-Albania*" në rubrikën "Hapësira ime", për plotësimin e të metave brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit. Struktura përgjegjëse ndihmon në mënyrë aktive kandidatin për plotësimin e të metave të konstatuara. Mosplotësimi i të metave brenda afatit 5-ditor përbën shkak për mospranimin e kërkesës.

Neni 7
Verifikimi i kritereve

1. Struktura përgjegjëse, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi për vazhdimin e procedurës së verifikimit ose përfundimit të afatit për plotësimin e të metave, verifikon nëse kandidatët plotësojnë kriteret për të vepruar si administrator, në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

2. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përmbushjen e kritereve për të vepruar si administrator, nuk është i plotë e i saktë ose ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tij, struktura përgjegjëse mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga çdo organ publik apo persona të tjerë juridikë, vendas ose të huaj.

3. Në përfundim të verifikimit për plotësimin e kritereve për të vepruar si administrator, struktura përgjegjëse harton relacionin shpjegues për secilin kandidat, ku pasqyrohen të dhënat e dokumentacionit të paraqitur dhe arsyet për pranimin ose rrëzimin e kërkesës, si dhe njoftimin përkatës.

Neni 8
Ankimi ndaj refuzimit të kërkesës

1. Kandidatët, të cilëve u është refuzuar kërkesa, kanë të drejtë të paraqesin ankim pranë ministrit të Drejtësisë, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, duke bashkëlidhur argumentet dhe dokumentacionin që provon përmbushjen e kritereve ligjore.

2. Struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë shqyrton ankimin dhe i propozon ministrit të Drejtësisë përfshirjen në listën e kandidatëve të kualifikuar, në rastet kur provohet përmbushja e kritereve për pjesëmarrje në provimin e kualifikimit ose skualifikimin përfundimtar të tij nga pjesëmarrja në provim. Ministri i Drejtësisë nxjerr urdhrin përkatës jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e paraqitjes së ankimit.

3. Ndaj urdhrit të ministrit për skualifikimin e kandidatit mund të bëhet ankim në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

SEKSIONI 2
ORGANIZIMI I PROVIMIT TË KUALIFIKIMIT

Neni 9
Provimi i kualifikimit

1. Provimi i kualifikimit të administratorëve zhvillohet në datën e caktuar me urdhër të ministrit të Drejtësisë, i cili publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Falimentimit dhe të Ministrisë së Drejtësisë, të paktën 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga përfundimi i afatit të publikimit të thirrjes për shprehje interesi.

2. Tarifa për pjesëmarrje në provimin e kualifikimit është 10 000 (dhjetë mijë) lekë dhe paguhet për llogari të Agjencisë Kombëtare të Falimentimit.

Neni 10
Ngritja dhe funksionimi i komisionit të provimit të kualifikimit

1. Komisioni i provimit të kualifikimit ngrihet me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

2. Komisioni përbëhet nga 3 përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Falimentimit dhe 2 përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Kryetar i komisionit caktohet një nga përfaqësuesit e Agjencisë Kombëtare të Falimentimit, që ka përvojë më të gjatë profesionale dhe në rast se të tre përfaqësuesit kanë të njëjtën përvojë profesionale, kryetar caktohet përfaqësuesi më i vjetër në moshë.

4. Komisioni mbështetet nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë Kombëtare të Falimentimit për mbarëvajtjen administrative dhe logjistike, të nevojshme për veprimtarinë e tij.

5. Përveç nëse parashikohet ndryshe në këtë vendim, në veprimtarinë e komisionit zbatohen, për aq sa gjejnë zbatim, dispozitat e legjislacionit në fuqi për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike.

Neni 11
Përgjegjësitë e komisionit të provimit të kualifikimit

Komisioni është përgjegjës për:

a) hartimin e tezave të provimit dhe përgjigjeve të tyre;

b) vlerësimin me pikë të përgjigjeve në provim;

c) shqyrtimin e ankimeve nga kandidatët ndaj rezultateve të publikuara;

ç) shpalljen e rezultateve përfundimtare të provimit të kualifikimit.

Neni 12
Deklarata e konfliktit të interesit

1. Pas njohjes me listën e kandidatëve të kualifikuar, anëtarët e komisionit nënshkruajnë një deklaratë personale se nuk ndodhen në rastet e pengesave ligjore të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative me kandidatët për administrator që marrin pjesë në provim.

2. Kur anëtari ndodhet në një nga këto raste, zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative për përjashtimin dhe zëvendësimin e tij.

Neni 13
Provimi i kualifikimit për administrator

1. Tezat e provimit hartohen me qëllim matjen e njohurive të kandidatëve mbi Kodin e Procedurës Civile, Kodin Civil, legjislacionin mbi falimentimin, mbi tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe legjislacionin që lidhet me të.

2. Provimi përmban pyetje me alternativa dhe me zhvillim, prej të cilave 2/3 janë me alternativa dhe 1/3 me zhvillim.

3. Vlerësimi i provimit të kualifikimit bëhet me maksimumin e mundshëm 100 (njëqind) pikë.

4. Kandidati kalon me sukses provimin e kualifikimit kur ka marrë të paktën 70 (shtatë-dhjetë) pikë.

Neni 14
Përgatitja e pyetjeve të provimit dhe përgjigjet

1. Pyetjet e provimit dhe përgjigjet e tyre përgatiten nga komisioni jo më herët se 1 (një) ditë para datës së zhvillimit të provimit dhe nuk u bëhen të ditura personave të tjerë.

2. Pyetjet hartohen në 3 (tri) teza të ndryshme dhe futen në zarfe të ndryshme prej të cilave zgjidhet njëri nga zarfet për t'u përdorur në provim. Të gjitha zarfet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e komisionit. E njëjta procedurë ndiqet edhe për përgjigjet e tezave të provimit.

3. Zgjedhja e zarfit bëhet me short ditën e zhvillimit të provimit dhe në prani të kandidatëve. Zarfi duhet të jetë i mbyllur dhe i nënshkruar.

Neni 15
Paraqitja dhe identifikimi i kandidatëve

1. Hyrja për në mjediset e brendshme të zhvillimit të provimit bëhet 1 (një) orë përpara orarit të njoftuar për zhvillimin e provimit dhe identifikimi i kandidatëve bëhet në bazë të një dokumenti identifikimi personal të vlefshëm dhe me fotografi, i cili mund të jetë letërnjoftim ose pasaportë. Kandidatët, që nuk kanë mjet identifikimi të vlefshëm, përjashtohen nga pjesëmarrja në provim, për të cilën mbahet procesverbali përkatës.

2. Kandidatët ftohen të zënë vendet sipas një përzgjedhjeje rastësore nga personat e caktuar për mbikëqyrjen e provimit dhe për asnjë arsye nuk lejohen të ndryshojnë vendin e caktuar ose të dalin jashtë.

Neni 16
Përzgjedhja dhe shpërndarja e tezës së provimit

1. Zarfi i zgjedhur, sipas pikës 3, të nenit 14, të këtij vendimi, hapet nga komisioni dhe teza e përzgjedhur u bëhet e ditur publikisht kandidatëve nga kryetari i komisionit.

2. Kandidatëve u shpërndahet teza e provimit dhe fleta e përgjigjeve. Teza e provimit nënshkruhet nga komisioni dhe përmban kodin e provimit. Kodi i provimit është një numër me dy ose më tepër shifra dhe unik për çdo kopje të provimit dhe për çdo kandidat.

3. Kandidatët plotësojnë kodin e provimit në fletën e përgjigjeve, si dhe përbri emrit të tyre në një fletë të posaçme të vënë në dispozicion nga personat e caktuar për mbikëqyrjen e provimit, e cila mbyllet në një zarf të veçantë.

Neni 17
Rregullat e sjelljes gjatë zhvillimit të provimit

1. Përpara fillimit të provimit, personat e caktuar për mbikëqyrjen e provimit udhëzojnë kandidatët për zbatimin e rregullave të sjelljes gjatë zhvillimit të provimit.

2. Pas këtij njoftimi, kandidatët plotësojnë një deklaratë me shkrim se u njohën me rregullat, dhe se shkelja e tyre përbën shkak për skualifikimin e menjëhershëm nga provimi. Refuzimi për nënshkrimin e deklaratës apo kundërshtimi i përmbajtjes së saj sjell humbjen e menjëhershme të së drejtës për të kryer provimin.

3. Kandidati që gjatë provimit nuk respekton udhëzimet e dhëna, njoftohet pa paralajmërim të ndërpresë provimin dhe të lërë menjëherë sallën, duke iu komunikuar edhe skualifikimi nga procedura e provimit.

4. Në tezën e provimit dhe fletën e përgjigjeve të kandidatit të skualifikuar, sipas pikës 3, të kësaj dispozite, bëhet shënimi "Skualifikohet", vihet në dijeni kryetari i komisionit dhe bëhet pasqyrimi në procesverbalin e provimit, ku shënohet nxjerrja jashtë procesit të vlerësimit të tezës së kandidatit të skualifikuar, si dhe shkaqet që kanë çuar në skualifikimin e kandidatit.

5. Procesverbali i provimit nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe bëhet pjesë e dosjes për procedurat e zhvilluara, duke i bashkëlidhur tezat e provimeve dhe fletët e përgjigjeve të kandidatëve të skualifikuar.

Neni 18
Procedura pas përfundimit të provimit

1. Pas përfundimit të kohës së caktuar për provimin, mblidhen fletët e përgjigjeve të provimit të kandidatëve dhe, nëse është rasti, bëhen shënimet përkatëse sipas parashikimeve të mësipërme.

2. Pas dorëzimit nga të gjithë kandidatët të fletëve të përgjigjeve të provimit, hapet zarfi ku ndodhen dy kopje me përgjigjet e tezës.

3. Komisioni administron njërën nga kopjet e përgjigjeve, ndërsa kopja tjetër publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Falimentimit dhe të Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 19
Korrigjimi i provimit dhe vlerësimi me pikë

1. Komisioni korrigjon provimet jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e përfundimit të provimit. Secili prej anëtarëve të komisionit kryen vlerësimin e pavarur të çdo testi dhe në fund përllogariten pikët mesatare të të gjithë anëtarëve për çdo pyetje. Në fund të korrigjimit, komisioni përllogarit shumën totale të pikëve të fituara nga çdo kandidat.

2. Administrimi i rezultateve të përfituara nga korrigjimi dokumentohet me procesverbal nga një prej anëtarëve të komisionit, që zgjidhet nga kryetari. Anëtarët e komisionit janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e diskutimeve në mbledhje.

3. Vlerësimi i provimeve nënshkruhet në çdo fletë nga të gjithë anëtarët e komisionit. Rezultatet e vlerësimit pasqyrohen në një listë, e cila përmban kodin dhe përbri pikët vlerësuese, si dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit.

4. Pas nënshkrimit të listës me kodet dhe pikët e vlerësimit për të gjitha provimet e korrigjuara, hapet zarfi me emrat dhe kodet e kandidatëve dhe përbri emrit dhe kodit të çdo kandidati shënohen pikët e fituara.

Neni 20
Publikimi i rezultateve të provimit

Lista me emrat, kodet dhe pikët e fituara nga kandidatët nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit. Një kopje e saj, e cila përmban vetëm kodet dhe pikët e fituara nga kandidatët, publikohet brenda ditës në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Falimentimit dhe të Ministrisë së Drejtësisë. Për efekt ankimi, publikimi është i barasvlershëm me njoftimin e çdo kandidati.

Neni 21
Ankimi ndaj rezultateve të provimit

Kandidatët, që kanë vërejtje për vlerësimin e provimit, kanë të drejtë të paraqesin ankim brenda 3 (tri) ditëve nga dita e publikimit të listës. Komisioni shqyrton ankimet jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas kalimit të këtij afati dhe njofton ankuesin mbi shqyrtimin e ankimit përmes portalit qeveritar "*e-Albania*".

Neni 22
Lista përfundimtare e fituesve

Komisioni, pas kalimit të afatit të ankimit apo shqyrtimit të ankimeve të paraqitura, sipas nenit 21, të këtij vendimi, përgatit listën përfundimtare të fituesve të provimit, e cila publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Falimentimit dhe të Ministrisë së Drejtësisë. Lista përfundimtare publikohet sipas renditjes së pikëve dhe kodit të provimit për secilin kandidat, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

SEKSIONI 3
DHËNIA E LICENCËS

Neni 23
Pajisja e kandidatëve fitues me licencë

1. Kandidatët fitues, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga publikimi i listës përfundimtare të fituesve, paraqesin vërtetimin për kryerjen e pagesës së tarifës, sipas pikës 4, të këtij neni, dhe pajisen me licencë.

2. Licenca lëshohet edhe elektronikisht me vulë/nënshkrim elektronik përmes portalit qeveritar *"e-Albania"*.

3. Licenca e administratorit ka afat 3-vjeçar dhe i jep të drejtë kandidatit fitues të ushtrojë profesionin e administratorit në Republikën e Shqipërisë.

4. Tarifa për pajisjen me licencë është 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë dhe paguhet për llogari të Agjencisë Kombëtare të Falimentimit.

Neni 24
Regjistrimi i licencës

1. Agjencia Kombëtare e Falimentimit regjistron menjëherë licencën për administrator në Regjistrin e Administratorëve.

2. Agjencia njofton gjykatat e falimentimit dhe strukturën përgjegjëse për administrimin e regjistrit elektronik të ekspertëve në Ministrinë e Drejtësisë për licencën e lëshuar.

Neni 25
Rinovimi i licencës

1. Licenca rinovohet në bazë të kërkesës me shkrim të administratorit, e cila depozitohet në Agjencinë Kombëtare të Falimentimit, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike përpara datës së mbarimit të afatit të vlefshmërisë së saj.

2. Kërkesa shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

a) kopjen e dokumentit të identifikimit;

b) deklaratën e kërkuesit se vazhdon të plotësojë kriteret për mbajtjen e licencës;

c) dokumentacionin për aktivitetet e kryera në fushën e falimentimit, për të paktën 3 (tre) vjetët e fundit;

ç) deklaratën se ka marrë pjesë në trajnime vazhduese profesionale dhe/ose kurse në fushën e falimentimit të organizuara nga Agjencia;

d) deklaratën se kërkuesi nuk ka qenë subjekt i ndonjë mase disiplinore;

dh) vërtetimin e pagesave për detyrimet e përcaktuara nga Agjencia gjatë procedurës së mbikëqyrjes profesionale;

e) vërtetimin që provon pagesën e tarifës për rinovimin e licencës.

3. Tarifa për rinovimin e licencës është 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë dhe paguhet për llogari të Agjencisë Kombëtare të Falimentimit.

4. Kërkesa për rinovimin e licencës shqyrtohet nga struktura përgjegjëse në Agjencinë Kombëtare të Falimentimit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e paraqitjes së saj, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative.

5. Kur administratori nuk ndjek procedurën sipas këtij neni, ai trajtohet si kandidat për administrator.

KREU III
PROCEDURA PËR HEQJEN E LICENCËS

Neni 26
Heqja e licencës

Heqja e licencës së ushtrimit të profesionit të administratorit bëhet me urdhër të drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Falimentimit, kur administratori:

a) heq dorë nga ushtrimi i profesionit të administratorit, me kërkesën e tij;

b) humbet zotësinë për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë;

c) është dënuar pas marrjes së licencës me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

ç) vërtetohet se në momentin e marrjes së licencës e ka marrë atë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi;

d) ka kryer shkelje të rënda të konstatuara nga Agjencia Kombëtare e Falimentimit gjatë kontrollit dhe mbikëqyrjes.

Neni 27
Procedura për heqjen e licencës

1. Struktura përgjegjëse, në kuadër të mbikëqyrjes dhe kontrollit periodik të administratorëve, bën verifikimin e çdo informacioni të nevojshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe, në rast se konstaton një nga rastet e parashikuara në shkronjat "b", "c", "ç" dhe "d", të nenit 26, të këtij vendimi, i propozon drejtorit fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

2. Drejtori, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e marrjes së propozimit, udhëron fillimin e procedurës administrative dhe kryen hetimin administrativ, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Administrative.

3. Në përfundim të procedurës administrative, drejtori vendos për heqjen e licencës, kur vërtetohen kushtet e përcaktuara në nenin 26, të këtij vendimi. Urdhri i drejtorit për heqjen e licencës ka formë të shkruar në letër dhe hartohet në përputhje me nenet 99 dhe 100 të Kodit të Procedurës Adminstrative.

Neni 28
Njoftimi i urdhrit për heqjen e licencës

1. Agjencia Kombëtare e Falimentimit njofton administratorin, gjykatat e falimentimit dhe strukturën përgjegjëse për administrimin e regjistrit elektronik të ekspertëve në Ministrinë e Drejtësisë mbi urdhrin për heqjen e licencës.

2. Heqja e licencës pasqyrohet në Regjistrin e Administratorëve.

Neni 29
Ankimi

Administratori ka të drejtë të paraqesë ankim ndaj urdhrit për heqjen e licencës në gjykatën administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 30
Shfuqizime

Fjalia e dytë, e pikës 14, të vendimit nr. 542, datë 19.9.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Falimentimit", shfuqizohet.

Neni 31
Organet zbatuese

Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia Kombëtare e Falimentimit për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 32
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 295, datë 17.5.2023

PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z. FATMIR PRIFTI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023"; të vendimit nr. 23, datë 18.1.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2023", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të z. Fatmir Prifti në masën 2 000 000 (dy milionë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 296, datë 17.5.2023

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI, PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E MBROJTJES SË BIMËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes së bimëve, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI, MBI BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E MBROJTJES SË BIMËVE

Këshillit i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Malit të Zi (në vijim të referuar si "Palë Kontraktuese"),

me dëshirën për nxitjen e bashkëpunimit të tyre të ndërsjellë në fushën e mbrojtjes së bimëve;

me dëshirën për të përmirësuar mbrojtjen e territorit të tyre nga ndërhyrja e dëmtuesve të karantinës së bimëve dhe për të kufizuar humbjet që ndodhin si pasojë e veprimit të tyre;

në mënyrë që të lehtësojnë tregtinë e ndërsjellë dhe shkëmbimin e bimëve dhe produkteve bimore,

kanë rënë dakord si më poshtë.

Neni 1

Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, janë:

- në Republikën e Shqipërisë: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me seli në Tiranë;
- në Malin e Zi: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Menaxhimit të Ujërave me seli në Podgoricë.

Neni 2

Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) "bimët", bimët e gjalla dhe pjesët e tyre, duke përfshirë edhe farat, për aq kohë sa janë të synuara për mbjellje dhe jo për konsum ose përpunim;

b) "produktet bimore", materiale të papërpunuara me origjinë bimore (duke përfshirë drithërat) dhe ato produkte të përpunuara, të cilat, sipas natyrës së përpunimit të tyre, mund të krijojnë rrezik për përhapjen e dëmtuesve;

c) "dëmtuesit", çdo formë e jetës së bimëve ose kafshëve ose ndonjë agjenti patogjen, dëmtues ose potencialisht dëmtues për bimët ose produktet bimore;

d) "dëmtues karantinor", dëmtuesit potencialisht të rrezikshëm për ekonominë e vendit importues, të cilët nuk janë të pranishëm në vendin importues ose që janë të pranishëm, por që nuk janë të përhapur gjerësisht dhe janë të kontrolluara në mënyrë aktive dhe të zhdukur në mënyrë efikase.

Neni 3

Palët Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën mbi listat e dëmtuesve karantinorë, si dhe për kërkesat specifike të karantinës (ndalimet, kufizimet dhe kushtet fitosanitare), në lidhje me importin ose tranzitin/kalimin e bimëve dhe produkteve bimore.

Çdo ndryshim në listat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni duhet t'i njoftohet me

shkrim paraprakisht Palës tjetër Kontraktuese, duke i dhënë kohën e duhur përpara hyrjes së tyre në fuqi.

Neni 4

Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese duhet të informojë njëri-tjetrin pa vonesë mbi ndryshimet thelbësore në shfaqjen e dëmtuesve karantinorë, si dhe për masat e ndërmarra mbi kontrollin e dëmtuesve.

Neni 5

Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese duhet të sigurojnë që eksporti dhe tranziti/kalimi i ngarkesave në/përmes territorit shtetëror të Palëve Kontraktuese të kryhet përkatësisht në përputhje me dispozitat ligjore të vendit importues ose vendit të tranzitit.

Neni 6

Çdo ngarkesë për eksport, e cila i nënshtrohet inspektimit fitosanitar, duhet të shoqërohet nga një certifikatë fitosanitare e përpunuar, sipas modelit të përcaktuar në Konventën Ndërkombëtare të Mbrojtjes së Bimëve dhe e lëshuar nga autoriteti kompetent i Palës Kontaktuese.

Certifikata fitosanitare nuk përjashton të drejtën e vendit importues për të kryer në mënyrën e duhur inspektimin fitosanitar dhe për të ndërmarrë masat e nevojshme.

Neni 7

Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese duhet të informojnë njëra-tjetrën për pikat e hyrjes në të cilat duhet të kryhet importi, eksporti dhe tranziti i dërgesës.

Neni 8

Nëse me rastin e inspektimit fitosanitar janë zbuluar dëmtues karantinorë ose është konstatuar shkelje e rregullores së shtetit importues në fushën e mbrojtjes së bimëve, autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese ka të drejtë të refuzojë importin e ngarkesës ose ta shkatërrojë atë, ose të ndërmarrë masa të tjera të nevojshme fitosanitare.

Neni 9

Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese, duhet të:

a) shkëmbejnë rregulloret ligjore për mbrojtjen e bimëve jo më vonë se dy muaj nga data e hyrjes së tyre në fuqi;

b) mbështesin shkëmbimin e ekspertëve, me qëllim të njohjes së organizimit të mbrojtjes së bimëve, si dhe me përvojën dhe rezultatet shkencore në fushën e mbrojtjes së bimëve;

c) shkëmbejnë informacion për të gjitha revistat, monografitë dhe botimet e rëndësishme profesionale në fushën e mbrojtjes së bimëve, të cilat publikohen në shtetin e tyre përkatës.

Neni 10

Me qëllim përshpejtimin e transportit dhe zvogëlimin e rrezikut për ndërhyrjen e dëmtuesve karantinorë, inspektimi fitosanitar mund të kryhet nga autoritetet kompetente në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, nëse jepet pëlqimi për atë qëllim.

Procedura dhe kushtet e tjera të inspektimit fitosanitar përcaktohen nga autoritet kompetente të Palëve Kontraktuese për secilin rast individual.

Neni 11

Për të zgjidhur çështjet specifike në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshjeje, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese do të organizojnë, nëse është e nevojshme, takime të përbashkëta. Takimet do të zhvillohen në Malin e Zi dhe në Republikën e Shqipërisë, sipas rastit. Data dhe vendi i çdo takimi përcaktohen në bazë të marrëveshjes së ndërsjellë.

Të gjitha shpenzimet do të përballohen nga vetë Palët Kontraktuese.

Neni 12

Çdo mosmarrëveshje që mund të ndodhë gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet përmes konsultimeve dhe negociatave midis Palëve Kontraktuese. Nëse kjo nuk çon në rezultate të dëshirueshme, mosmarrëveshjet do të zgjidhen me rrugë diplomatike.

Neni 13

Kjo marrëveshje nuk shkel të drejtat dhe detyrimet e Palëve Kontraktuese që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat ato janë Palë Kontraktuese.

Neni 14

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pas tridhjetë ditëve nga dita e marrjes së notës/komunikimit më të fundit nëpërmjet rrugëve diplomatike nga njëra Palë Kontraktuese tek tjetra, që të gjitha kërkesat ligjore kombëtare për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje janë plotësuar.

Kjo marrëveshje është lidhur për një periudhë 5-vjeçare dhe do të zgjatet automatikisht për një periudhë tjetër prej 5 vjetësh, përveç kur njëra prej Palëve Kontraktuese e denoncon atë me shkrim nëpërmjet rrugëve diplomatike, të paktën 6 muaj përpara përfundimit të periudhës përkatëse të vlefshmërisë.

Bërë në Podgoricë, më 27.2.2023, në dy origjinale, në gjuhët shqipe, malazeze dhe angleze, ku secila prej tyre është njëlloj autentike.

Në rast të mospërputhjeve në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të jetë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Frida Krifca
MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

PËR QEVERINË E MALIT TË ZI
Vladimir Joković
ZËVENDËSKRYEMINISTËR PËR SISTEMIN EKONOMIK DHE MINISTËR I BUJQËSISË PYJEVE DHE MENAXHIMIT TË UJËRAVE

VENDIM
Nr. 297, datë 17.5.2023

PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR KRYERJEN E VEPRIMTARIVE TË SHFRYTËZIMIT NË FONDIN PYJOR KOMBËTAR NGA INDIVIDË APO SUBJEKTE TË LICENCUARA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 23, të ligjit nr. 57/2020, "Për pyjet", me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky vendim ka për qëllim të përcaktojë procedurat që ndiqen nga individët apo subjektet e licencuara gjatë kryerjes së veprimtarive të shfrytëzimit në Fondin Pyjor Kombëtar.

Neni 2
Përkufizime

Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e ligjit nr. 57/2020, "Për pyjet", ndërsa termat e mëposhtëm kanë kuptimin, si më poshtë vijon:

1. "Veprimtari shfrytëzuese në Fondin Pyjor Kombëtar", punimet apo aktivitetet në fondin pyjor, që kryejnë individët për nevojat vetjake apo subjektet e pajisura me lejen përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, lejet dhe autorizimet, kategoria III.4, të cilat zotërojnë të drejtën e shfrytëzimit, sipas legjislacionit në fuqi, si më poshtë vijon:

a) punimet për shfrytëzimin e lëndës drusore dhe të asortimenteve;

b) punimet dhe aktivitetet në infrastrukturën pyjore;

c) punimet për prerjet kulturore;

ç) punimet për mbrojtjen e tokës pyjore;

d) vjelja dhe grumbullimi i bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore (BMET) dhe prodhimeve pyjore jodrusore.

2. "Individ" ka kuptimin, sipas përcaktimit të pikës 22, të nenit 3, të ligjit nr. 57/2020, "Për pyjet", dhe ndjek procedurat e këtij vendimi vetëm në rastet e shfrytëzimit të fondit pyjor për nevojat e veta.

3. "Subjekti i licencuar", këtu e në vijim subjekti, ka kuptimin e personit fizik dhe juridik, që zotëron të drejtën e shfrytëzimit në Fondin Pyjor Kombëtar, pasi të jetë pajisur me lejen përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, lejet dhe autorizimet, kategoria III.4, për ushtrimin e veprimtarive të shfrytëzimit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

4. "Transport i largët", transporti i lëndës drusore nga sheshet e depozitimit drejt pikës së magazinimit apo shitjes.

5. "Sheshi i depozitimit" ka kuptimin e një vendi të caktuar brenda parcelës ose grup-parcelave të përcaktuara për shfrytëzim, ku depozitohet e stivoset lënda drusore pas përfundimit të transportit të brendshëm.

6. "Punimet për mbrojtjen e tokës pyjore" kanë kuptimin e kryerjes së pyllëzimit dhe të sistemimeve malore.

KREU II
PROCEDURAT E KRYERJES SË VEPRIMTARIVE TË SHFRYTËZIMIT

Neni 3
Procedura e shfrytëzimit të lëndës drusore dhe asortimenteve në Fondin Pyjor Kombëtar

1. Individi apo subjekti, që zotëron të drejtën e shfrytëzimit, kërkon nga struktura përgjegjëse për pyjet në bashki projektin teknologjik të shfrytëzimit dhe lejen përkatëse të shfrytëzimit.

2. Struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga administrimi i kërkesës, pajis me projektin teknologjik dhe lejen e shfrytëzimit individin apo subjektin.

3. Struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, brenda 5 (pesë) ditëve nga vënia në dispozicion e projektit dhe lejes përkatëse të shfrytëzimit, i dorëzon individit apo subjektit parcelën apo parcelat që janë objekt i shfrytëzimit.

4. Pas marrjes në dorëzim, individi apo subjekti, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse, si dhe në përputhje me afatet e parashikuara në kontratë kryejnë procedurat e nevojshme, si më poshtë vijon:

a) përforcojnë me shenja të veçanta dhe të kuptueshme drurët e damkosur;

b) caktojnë vendet, të cilat nevojiten për instalime të përkohshme në funksion të skemave teknologjike të shfrytëzimit, të tilla si skelat e ngarkimit, sheshet e depozitimit etj.;

c) përcaktojnë një vend për ngritjen e kampingut të punëtorëve, në rastin kur lëvizja ditore e punëtorëve nga qendra e banuar në vendin e punës dhe anasjelltas, është e pamundur për shkaqe që lidhen me largësinë etj.;

ç) marrin përsipër dorëzimin e vendit të kampingut të punëtorëve, pas përfundimit të shfrytëzimeve, si në gjendjen fillestare të tij, pa mbetje dhe pa dëmtime;

d) brenda periudhës së shfrytëzimit të përcaktuar në lejen e shfrytëzimit, kanë detyrimin e mbrojtjes së sipërfaqes pyjore, në të cilën do të kryhet veprimtaria e lejuar, sipas përcaktimeve në kontratën e përbashkët me pronarin.

5. Në rastin kur në kontratë është përcaktuar që individi apo subjekti të kryejë transportin e largët të lëndës drusore, individi apo subjekti i kontraktuar i kërkon strukturës përgjegjëse për pyjet në bashki pajisjen me vërtetim transporti për përmbushjen e detyrimit kontraktor.

6. Vërtetimi i transportit plotësohet dhe lëshohet nga struktura përgjegjëse për pyjet në bashki në sheshin e depozitimit, pas kryerjes së matjeve përkatëse të lëndës drusore që do të transportohet.

7. Para kryerjes së transportit të largët të lëndës drusore nga sheshet e depozitimit apo skelat e ngarkimit, individi apo subjekti shënon lëndën drusore me bojë, sipas ngjyrës së përcaktuar e të miratuar nga bashkia.

Neni 4
Procedura për kryerjen e punimeve dhe aktivitetet në infrastrukturën pyjore

1. Punimet dhe aktivitetet në infrastrukturën pyjore kryhen vetëm nga subjekte që zotërojnë të drejtën e shfrytëzimit.

2. Për punimet dhe aktivitetet në infrastrukturën pyjore, subjekti, pasi ka lidhur kontratën përkatëse me bashkinë, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse në bashki, ndjek procedurën e mëposhtme:

a) I kërkon strukturës përgjegjëse në bashki, brenda 5 (pesë) ditëve, t'i dorëzojë subjektit projektin përkatës, që do të zbatohet në infrastrukturën pyjore;

b) Shënon me shenja të qarta në terren gjurmën, për të cilën do të zbatohet projekti.

3. Në rast se gjatë zbatimit të projektit, druri apo grup-drurësh rrezikohen të dëmtohen gjatë kryerjes së punimeve, struktura përgjegjëse për pyjet merr masat për mbrojtjen e tyre, duke ngarkuar subjektin që kryen punimet, për krijimin e kushteve mbrojtëse të tyre, të tilla si gardhimi apo krijimi i

strukturave që pengojnë dëmtimin e pjesëve të drurit.

4. Në rastin kur mbrojtja e parashikuar në pikën 3, të këtij neni, është e pamundur, pasi pengon zhvillimin e projektit, atëherë struktura përgjegjëse për pyjet në bashki merr masat për prerjen dhe largimin e drurit apo të grupit të drurëve, si më poshtë vijon:

a) kryen verifikime në terren në vendin ku zbatohet projekti dhe harton një raport teknik, i cili përmban të dhëna për volumet e lëndës drusore dhe vlerat financiare që nevojiten për prerjen dhe largimin e saj. Më pas vijohet me prerjen dhe largimin e drurëve, sipas akteve nënligjore në fuqi për pyjet;

b) nëse volumi i drurëve që priten është më pak ose i barabartë me 50 m^3 (metër kub), struktura përgjegjëse për pyjet në bashki ndjek procedurat për prerjen dhe largimin e tyre dhe brenda 5 (pesë) ditëve njofton:

i. strukturat përgjegjëse për pyjet në ministri;

ii. strukturat përgjegjëse të kontrollit në pyje;

c) kur volumi i drurëve që priten është më i madh se 50 m^3 (metër kub), kjo sasi trajtohet nga struktura përgjegjëse për pyjet, sipas procedurës së miratimit të mundësisë vjetore të shfrytëzimit;

ç) pavarësisht procedurave të përcaktuara në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 4, të këtij neni, volumet e drurëve të prerë të jenë në përputhje me mundësinë vjetore të shfrytëzimit, të përcaktuara në planin e mbarështimit dhe në asnjë rast ato nuk duhet ta tejkalojnë atë.

5. Në rastin kur gjatë zbatimit të projektit bëhet i domosdoshëm transporti i largët i lëndës drusore, atëherë subjekti, i cili është kontraktuar për të kryer transportin e largët të lëndës drusore, kërkon nga struktura përgjegjëse për pyjet në bashki pajisjen me vërtetim transporti.

6. Vërtetimi i transportit plotësohet dhe lëshohet nga struktura përgjegjëse për pyjet në sheshin e depozitimit, pasi ka kryer matjet përkatëse të lëndës drusore që do të transportohet.

Neni 5

Procedura për kryerjen e punimeve për prerjet kulturore

1. Punimet për prerjet kulturore kryhen vetëm nga subjekte që zotërojnë të drejtën e shfrytëzimit të fondit pyjor.

2. Për punimet për prerjet kulturore, subjekti, pasi ka lidhur kontratën përkatëse me bashkinë, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse në bashki, ndjek procedurën e mëposhtme:

a) i kërkon strukturës përgjegjëse të pyjeve në bashki që, brenda 5 (pesë) ditëve nga lidhja e kontratës, ta pajisë me projektin përkatës për punimet për prejet kulturore dhe lejen përkatëse, për këtë qëllim;

b) shënon me shenja të qarta në terren sipërfaqen, për të cilën do të zbatohen prerjet kulturore, si dhe shënon me shenja të dallueshme të gjithë drurët që do të hiqen gjatë prerjeve kulturore.

3. Kur gjatë këtyre punimeve rezulton të ketë asortimente të lëndës drusore, të tilla si lëndë punimi apo dru zjarri, subjekti i kërkon strukturës përgjegjëse për pyjet që të bëjë vlerësimin e saj, nëse një gjë e tillë nuk ka qenë e parashikuar në projekt.

4. Në rastin kur gjatë zbatimit të projektit bëhet i domosdoshëm transporti i largët i lëndës drusore, atëherë subjekti, i cili është kontraktuar për të kryer transportin e largët të lëndës drusore, kërkon nga struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, që ta pajisë me vërtetim transporti.

5. Vërtetimi i transportit plotësohet dhe lëshohet nga struktura përgjegjëse për pyjet në sheshin e depozitimit, pasi ka kryer matjet përkatëse të lëndës drusore që do të transportohet.

6. Brenda periudhës së përcaktuar në lejen për prerjet kulturore, subjekti merr përsipër mbrojtjen e të gjithë sipërfaqes, në të cilën kryen veprimtarinë e lejuar, sipas përcaktimeve në kontratën e përbashkët me pronarin.

7. Pas përfundimit të punimeve, subjekti i kërkon strukturës përgjegjëse për pyjet vlerësimin e punimeve të kryera dhe dorëzimin e objektit.

8. Struktura përgjegjëse për pyjet, pas përfundimit të punimeve, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, merr në dorëzim objektin, duke analizuar, vlerësuar dhe konstatuar në bazë të provave administrative, që punimet janë kryer në përputhje me projektin teknik.

9. Procedura e dorëzimit të objektit nga ana e subjektit dhe ajo e marrjes në dorëzim të tij nga struktura përgjegjëse për pyjet shënohen në procesverbalin e dorëzimit.

Neni 6
Procedura për kryerjen e punimeve për mbrojtjen e tokës pyjore

1. Punimet për mbrojtjen e tokës pyjore kryhen vetëm nga subjekte që zotërojnë të drejtën e shfrytëzimit në fondin pyjor.

2. Për punimet për mbrojtjen e tokës, subjekti, pasi ka lidhur kontratën përkatëse me bashkinë, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse në bashki, ndjek procedurën e mëposhtme:

a) i kërkon strukturës përgjegjëse për pyjet në bashki që, brenda 5 (pesë) ditëve nga lidhja e kontratës, ta pajisë me projektin përkatës për punimet për mbrojtjen e tokës pyjore dhe me lejen përkatëse për këtë qëllim;

b) struktura përgjegjëse për pyjet kryen shënjimin e qartë në terren të sipërfaqes, për të cilën do të zbatohet projekti.

3. Në rastin e punimeve për sistemimet malore, struktura përgjegjëse për pyjet përcakton rrugët për transportin e lëndëve të para që nevojiten për ndërtim, veçanërisht në rastin kur transporti kryhet me kafshë dhe kalon përmes sipërfaqeve të pyllëzuara.

4. Pas përfundimit të punimeve, subjekti i kërkon strukturës përgjegjëse për pyjet që të vlerësojë punimet e kryera dhe të dorëzojë objektin.

5. Struktura përgjegjëse për pyjet, pas përfundimit të punimeve, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve merr në dorëzim objektin, duke analizuar, vlerësuar dhe konstatuar në bazë të provave administrative, që punimet janë kryer në përputhje me projektin teknik.

6. Procedura e dorëzimit të sipërfaqes pyjore nga subjekti dhe ato të marrjes në dorëzim të tij nga ana e strukturës përgjegjëse për pyjet shënohen në procesverbalin e dorëzimit.

Neni 7
Procedura për vjeljen dhe grumbullimin e bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore (BMET) dhe prodhimeve pyjore jodrusore

1. Punimet për vjeljen dhe grumbullimi i bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore dhe prodhimeve pyjore jodrusore (në vijim "BMET") kryhen nga individë apo subjekte, që zotërojnë të drejtën e shfrytëzimit në fondin pyjor.

2. Për BMET-të, individi apo subjekti, pasi ka lidhur kontratën përkatëse me bashkinë dhe është pajisur me lejen përkatëse, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse në bashki, ndjek procedurën e mëposhtme:

a) pajiset nga bashkia, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e depozitimit të kërkesës, me projektin përkatës për vjeljen dhe grumbullimin e BMET-ve dhe prodhimeve pyjore jodrusore dhe me lejen përkatëse;

b) struktura përgjegjëse për pyjet në bashki bën shënjimin e qartë në terren të sipërfaqes për të cilën do të zbatohet projekti.

3. Në rastin kur gjatë zbatimit të projektit bëhet i domosdoshëm transporti i largët i prodhimeve të dyta, atëherë individi apo subjekti kërkon nga struktura përgjegjëse për pyjet në bashki pajisjen me vërtetim transporti.

4. Vërtetimi i transportit plotësohet dhe lëshohet nga struktura përgjegjëse për pyjet në vendin e depozitimit, pasi ka kryer vlerësimet përkatëse të BMET-ve dhe prodhimeve pyjore jodrusore që do të transportohen.

5. Brenda periudhës së përcaktuar në lejen përkatëse, subjekti merr përsipër mbrojtjen e të gjithë sipërfaqes, në të cilën kryen veprimtarinë e lejuar, sipas përcaktimit në kontratën e përbashkët me pronarin.

6. Pas përfundimit të punimeve, subjekti i kërkon strukturës përgjegjëse për pyjet që të vlerësojë kryerjen e veprimtarisë së BMET-ve dhe të prodhimeve pyjore jodrusore dhe të dorëzojë sipërfaqen e shfrytëzuar pyjore.

7. Struktura përgjegjëse për pyjet, pas përfundimit të punimeve, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, merr në dorëzim objektin, duke analizuar, vlerësuar dhe konstatuar në bazë të provave administrative që punimet janë kryer në përputhje me projektin teknik.

8. Procedura e dorëzimit të sipërfaqes pyjore nga subjekti dhe ato të marrjes në dorëzim të tij nga ana e strukturës përgjegjëse për pyjet shënohen në procesverbalin e dorëzimit.

9. Me kërkesë të subjektit, struktura përgjegjëse për pyjet, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, lëshon certifikatën e origjinës për BMET-të dhe prodhimet pyjore jodrusore.

Neni 8
Dispozita të fundit

Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

UDHËZIM
Nr. 12, datë 2.5.2023

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN E PËRBASHKËT NR. 1, DATË 10.3.2020, "PËR RREGULLAT DHE MASAT PËR TRAJTIMIN E AMBALAZHEVE DHE PALETAVE PREJ DRURI"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; si dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr. 105/2016, datë 14.10.2016, "Për mbrojtjen e bimëve", të ndryshuar, ministri përgjegjës për bujqësinë dhe ministri përgjegjës për mjedisin

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin e përbashkët nr. 1, datë 10.3.2020, "Për rregullat dhe masat për trajtimin e ambalazheve dhe paletave prej druri", bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

1. Kudo në udhëzimin e përbashkët emërtimi "agjencive rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve (ARSHVMB)", zëvendësohet me emërtimin "drejtoritë rajonale të veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve (DRVMB)".

2. Në pikën 2, të nenit 9, pikën 3, të nenit 10, dhe shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 11, togfjalëshi "struktura përgjegjëse e mbrojtjes së bimëve (SPMB)" dhe shkurtimi "SPMB" zëvendësohen përkatësisht me "Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB)", dhe shkurtimin "AKVMB".

3. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen strukturat përkatëse të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, që lidhen me mbrojtjen e bimëve dhe pyjet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro

URDHËR
Nr. 4, datë 11.5.2023

PËR SHPALLJEN E "THIRRJES SË TETË" NË KUADËR TË PROGRAMIT KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 6, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 395, datë 29.4.2015, "Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e "Thirrjes së tetë", në kuadër të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës me mbështetjen e institucioneve të administratës shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, institucioneve të tjera publike, njësive të vetëqeverisjes vendore, shoqërive tregtare dhe organizatave jofitimprurëse, brenda muajit qershor 2023.

2. Programi Kombëtar i Praktikave të Punës për vitin 2023 do të realizohet sipas planit të veprimit dhe metodologjisë bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Grupi i Punës për realizimin e "Thirrjes së tetë" të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT
Bora Muzhaqi

METODOLOGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT NË KUADËR TË PROGRAMIT KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS, THIRRJA E TETË

Në zbatim të vendimit nr. 395, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike", të ndryshuar, Programi Kombëtar i Praktikave të Punës do të realizohet sipas planit të veprimit dhe metodologjisë së miratuar nga ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, që përcakton shpalljen për thirrjen e radhës, afatin për aplikim, dokumentet për aplikim dhe mënyrën e vlerësimit.

1. Puna përgatitore për planifikimin e nevojave

a) Institucionet e përfshira në këtë program i komunikojnë ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, personat e kontaktit për programin, numrin e praktikantëve dhe profilet e tyre studimore;

b) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët është përgjegjës për mbledhjen e të dhënave dhe plotësimin e databazës për të gjitha institucionet e përfshira në program;

c) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët përgatit materialet për publikim në platformën *online*: *https://praktika.riniafemijet.gov.al*;

d) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mban komunikimin me personat e kontaktit të të gjithë institucioneve të përfshira në program;

e) Ministritë, institucionet e tjera publike, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe shoqëritë tregtare, nëpërmjet personave të kontaktit të konfirmuar, organizojnë dhe udhëzojnë institucionet dhe njësitë në varësi, në lidhje me tërësinë e procesit të zhvillimit të programit.

2. Përgatitja dhe shpallja e procesit të aplikimit

a) Aktivizimi i platformës *online* për aplikim: *https://praktika.riniafemijet.gov.al*;

b) Shpallja e thirrjes realizohet nga ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, me pjesëmarrjen e institucioneve të tjera bashkëpunuese;

c) Shpallja e thirrjes i dërgohet institucioneve, të cilat kanë për detyrim ta publikojnë në faqet e tyre zyrtare dhe mediat sociale;

d) Procesi i aplikimit fillon në datën 1 qershor 2023 dhe përfundon në 30 qershor 2023;

e) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka të drejtë të zgjasë afatin e aplikimit.

3. Kriteret e aplikimit

a) Aplikantët duhet të kenë mbushur 21 vjeç deri në datën 1 shtator 2023, si dhe të jenë deri në 26 vjeç në datën 1 shtator 2023 (fillimi i programit të praktikës);

b) Aplikantët duhet të jenë minimalisht të diplomuar në programet e studimit të ciklit të parë "Bachelor", deri në datën 1 shtator 2023;

c) Aplikantët nuk duhet të kenë qenë pjesë e programit në thirrjet e mëparshme, pasi qëllimi i tij është ofrimi i një përvoje kualifikuese, që ndikon në zhvillimin e aftësive profesionale e të shprehive të tyre praktike, në njohje me sistemin administrativ publik, shoqëritë tregtare dhe organizatat jofitimprurëse.

4. Kohëzgjatja e programit

a) Programi Kombëtar i Praktikës së Punës, thirrja e tetë, do të zgjasë 3 (tre) muaj;

b) Programi fillon në datën 1 shtator 2023 dhe përfundon në datën 1 dhjetor 2023.

5. Procesi i aplikimit

a) Aplikimi kryhet në platformën zyrtare të programit: *https://praktika.riniafemijet.gov.al*;

b) Në platformën e aplikimit publikohen profilet studimore të kërkuara nga institucionet pjesëmarrëse në program, me qëllim orientimin e kandidatëve.

6. Formati i aplikimit

Në formatin e aplikimit kërkohen të dhënat si më poshtë:

a) të dhënat personale;

b) studimet e fundit të përfunduara;

c) përcaktimi i mesatares së studimeve të fundit të përfunduara, me të cilat aplikanti po kandidon;

d) jetëshkrimi;

e) letra e motivimit, në të cilën kërkohet të shpjegohet se si kjo praktikë në institucionin përkatës do të ndikonte në rritjen e tij/saj profesionale.

7. Fushata e komunikimit për thirrjen e tetë

a) Institucionet pjesëmarrëse në program bashkëpunojnë për publikimin e thirrjes së tetë të programit;

b) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët organizon takime informuese me studentë, të rinj, organizatat rinore dhe/ose organizatat për të rinjtë, shoqëritë tregtare, etj.

8. Ngritja e komisioneve përzgjedhëse

a) Institucionet pjesëmarrëse ngrenë komisionet përzgjedhëse përpara mbarimit të afatit të aplikimit;

b) Institucionet përcaktojnë nëse njësitë nën varësi ngrenë komisione përzgjedhëse apo përzgjedhja realizohet nga vetë institucioni, nga i cili kanë varësi; mbështetur në kërkesat e profileve studimore të deklaruara;

c) Komisioni është i përbërë nga minimalisht 3 (tre) persona;

d) Personi i kontaktit i institucionit është anëtar;

e) Nëpërmjet personave kontakt të konfirmuar, organizojnë dhe udhëzojnë institucionet dhe njësitë nën varësi, në lidhje me tërësinë e procesit të ngritjes së komisioneve.

9. Komunikimi i aplikimeve

a) Personi i kontaktit i ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët i dërgon në format elektronik aplikimet e marra në platformë për institucionin personave të kontaktit të programit, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga mbyllja e aplikimeve;

b) Ministritë, institucionet e tjera publike, njësitë e vetëqeverisjes vendore, shoqëritë tregtare dhe organizatat jofitimprurëse dërgojnë elektronikisht aplikimet në personat e kontaktit të institucioneve dhe njësive që kanë vartësi dhe në të cilat janë ngritur komisione përzgjedhëse.

10. Përzgjedhja e kandidatëve fitues

Vlerësimi: Vlerësimi maksimal është 40 pikë dhe kryhet, si më poshtë:

I. Vlerësimi për nivelin e diplomës:

a) Bachelor 5 pikë;

b) Master profesional 10 pikë;

c) Master shkencor 15 pikë.

II. Vlerësimi për mesataren e notave:

a) 5–6 5 pikë;

b) 7–8 10 pikë;

c) 9–10 15 pikë.

III. Letra e motivimit vlerësohet nga 1 deri në 10 pikë.

Përzgjedhja:

a) Përzgjedhja e kandidatëve mbështetet në profilet studimore të kërkuara nga institucioni, të cilat shpallen në platformën e aplikimit për thirrjen e tetë;

b) Komisioni harton listën me kandidatët sipas renditjes së pikëve, ndarë sipas profileve studimore;

c) Komisioni shpall listën fituese sipas profileve studimore, brenda 3 (tre) ditëve pune nga dërgimi i aplikimeve;

d) Komisioni harton listën e kandidatëve në pritje.

11. Lajmërimi i fituesve

a) Institucioni pjesëmarrës në program është përgjegjës për lajmërimin dhe verifikimin e fituesve brenda 2 (dy) ditëve pune nga shpallja e fituesve;

b) Fituesit lajmërohen mbi datën e paraqitjes në institucion dhe dokumentacionin që duhet të dorëzohet në institucionin ku kryhet programi;

c) Institucionet e përfshira në program dërgojnë elektronikisht, pranë ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, emrat e praktikantëve që rezultojnë fitues të procesit të përzgjedhjes dhe verifikimit, brenda 6 (gjashtë) ditëve pune nga data e dërgimit të aplikimeve, sipas formatit dhe të dhënave të përcaktuara nga ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët;

d) Ankimimet bëhen brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga shpallja e fituesve.

12. Procesi i rishpërndarjes

a) Në rast se institucioni nuk plotëson vendet e kërkuara me aplikimet e marra, mund të kërkojë kandidatë nga institucionet brenda të njëjtit sistem ministror, bashkiak apo të biznesit, si dhe mund të kërkojnë nga aplikimet e tjera, sipas sistemeve përkatëse, brenda 2 (dy) ditëve pune nga dërgimi i listës fituese;

b) Koordinimin e rishpërndarjes e realizon personi i kontaktit i ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët brenda 3 (tre) ditëve pune nga dërgimi i kërkesës së institucioneve për vendet e paplotësuara;

c) Institucionet përzgjedhin mes aplikantëve të dërguar nga personi i kontaktit i ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët sipas të njëjtës metodologji më sipër dhe shpallin fituesit brenda 2 (dy) ditëve nga dërgimi i aplikimeve shtesë.

13. Angazhimi i praktikantit në orë pune

a) Praktikanti do të kryejë praktikën e punës pranë institucionit ku është pranuar, çdo ditë, nga e hëna deri të premten, orar zyrtar;

b) Praktikanti, që të certifikohet për përfundimin me sukses të programit, duhet të ketë marrë pjesë minimalisht në 80 % të periudhës së zhvillimit të programit.

14. Fillimi i programit

a) Kandidati fitues dorëzon tek personi i kontaktit në institucion, jo më vonë se 10 ditë pasi ka filluar programin: jetëshkrim, fotokopje e ID-së, kopje e noterizuar e listës së notave të studimeve të

përfunduara, kopje e noterizuar e diplomës së studimeve të përfunduara;

b) Personi i kontaktit në çdo institucion konfirmon të dhënat e deklaruara në aplikim;

c) Në qoftë se kandidati ka bërë deklarim të rremë nuk kualifikohet;

d) Në rast skualifikimi apo të tërheqjes nga programi të një kandidati, personi i kontaktit i programit përzgjedh të renditurin në radhë, me të njëjtin profil studimor, me pikët më të larta për atë institucion, sipas listës së pritjes së hartuar nga komisioni;

e) Pas konfirmimit të të dhënave, nënshkruhet marrëveshja midis institucionit ku kryhet praktika dhe praktikantit, brenda 14 ditësh kalendarike nga fillimi i programit;

f) Marrëveshja tip hartohet nga ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët;

g) Personi i kontaktit në çdo institucion koordinon procesin e përcaktimit të një mbikëqyrësi për secilin praktikant, i cili përmbush kriteret dhe detyrat e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 395, datë 29.4.2015, të ndryshuar, pikat 8 dhe 9.

15. Përfundimi i programit për thirrjen e tetë

a) Hartohen nga grupi i punës dhe miratohen nga ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët formularët e vlerësimit për praktikantët nga mbikëqyrësit dhe formularët e vlerësimit të mbikëqyrësit nga praktikanti;

b) Javën e fundit të zhvillimit të programit plotësohen formularët e vlerësimit nga mbikëqyrësi për praktikantët dhe nga praktikantët për mbikëqyrësit;

c) Grupi i punës së ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët harton formatin e certifikatës për praktikantët që kanë zhvilluar me sukses programin;

d) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët verifikon me çdo institucion të përfshirë listën e praktikantëve që kanë kryer me sukses praktikën tremujore;

e) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët përgatit certifikatën për çdo praktikant që ka përfunduar me sukses praktikën dhe i dërgon certifikatat tek institucionet përkatëse;

f) Institucionet realizojnë shpërndarjen e certifikatave te praktikantët.

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2023 - Numri: 77
Datë: 2023/05/19 13:21:41
1fb4cf37-777d-4fe6-9809-7a8ea50aa1eb

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 176 lekë